



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. _____ Regj.
2019

Ballsh, më ____ . ____ .

Lënda: **Dërgohet për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, Formulari i Njoftimit të Fituesit**

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK – TIRANË (SPE)

për ngarkim në sistemin e prokurimit elektronik të APP, në adresën www.app.gov.al

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
BASHKIA MALLAKASTËR

Data 12.02.2019

Për: **Operatorin Ekonomik “Avduli” shpk, me NIPT J667033060, me adresë Lagjja “10 Korriku”, Rr. “Perlat Rexhepi”, objekt 3 katësh, nr.4, kati 1, Vlorë.**

* * *

Procedura e prokurimit: **“E hapur”**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-02308-12-27-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikualifikim i bllokut të pallateve të Tecit, lagjia 5 Shkurti”**, me fond limit **27.083.333** (njëzetë e shtatë milion e tetëdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH**, me afat 4 muaj.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.52, datë 31 dhjetor 2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik **“AVDULI” shpk**, me NIPT J667033060, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën **25.729.070** (njëzetë e pesë milion e shtatëqind e njëzetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë) **lekë pa TVSH**.
2. Operatori Ekonomik **“ELDA-VL” shpk**, me NIPT K67106202W, **nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.**

3. Operatori Ekonomik “**FLED**” shpk, me NIPT K17621104C, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën **26.250.710** (njëzetë e gjashtëmilion e dyqind e pesëdhjetëmijë e shtatëqind e dhjetë) **lekë pa TVSH**.
4. Operatori Ekonomik “**GRAND KONSTRUKSION M**” shpk, me NIPT L38109801T, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën **26.388.310** (njëzetë e gjashtëmilion e treqind e tetëdhjetë e tetëmijë e treqind e dhjetë) **lekë pa TVSH**.
5. Operatori Ekonomik “**SHENDELLI**” shpk, me NIPT K07924803N, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën **26.171.557** (njëzetë e gjashtëmilion e njëqind e shtatëdhjetë e njëmijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH**.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk, për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson asnjë prej kërkesave të kualifikimit, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e tyre. Ky operator nuk ka paraqitur as ofertë ekonomike.

2. Operatori Ekonomik “FLED” shpk, për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “h”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton se disponon në një nga format e kërkuara: dy afaltoshtuese, një rrul gome për asfalt mbi 14 ton, një rrul gome për asfalt mbi 9 ton, një rrul hekur mbi 10 ton, një autobitumatriçe, një autobot, 2 gjeneratorë 50 KW, një autobot, një grejder dhe një batipal.

3. Operatori Ekonomik “GRAND KONSTRUKSION M” shpk, për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi kontrata e paraqitur me objekt “Masa inxhinierike për mirëmbajtjen e linjës së ujësjellësit, fshati Bence, Tepelenë”, është një kontratë e një tjetër natyre punimesh dhe rrjedhimisht nuk mund të konsiderohet si punë e ngjashme për të vërtetuar plotësimin e kësaj kërkesë.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk është paraqitur licenca profesionale e shoqërisë.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “e”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton se ka në stafin e shoqërisë drejtuesit teknik si: një inxhinier ndërtimi, një inxhinier mjedisi, një inxhinier topograf/geodet, një inxhinier elektrik.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “g”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton se ka të punësuar në stafin e shoqërisë një mjek ndërmarrjeje.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “h”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”,

të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton se disponon në një nga format e kërkuara: dy afaltoshtuese dhe një autobitumatriçe.

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “i”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit.

4. Operatori Ekonomik “SHENDELLI” shpk, për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 2.2 “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve fundit (2015, 2016, 2017).
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “i”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “Avduli” shpk, me NIPT J667033060, me adresë Lagjja “10 Korriku”, Rr. “Perlat Rexhepi”, objekt 3 katësh, nr.4, kati 1, Vlorë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **25.729.070** (njëzetë e pesëmilion e shtatëqind e njëzetë e nëntëmijë e shtatëdhjetë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër lagjja “18 Prilli”, Ballsh, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 04.02.2019

Ankesa: Nuk ka patur ankesa.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Agron Kapllanaj